



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria Komunale e Arsimit
Prishtinë
Nr.97, datë 04.02.2016

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52:

SHBALL KONKURS PLOTESUES

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE
PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Të gjitha detajet rreth grup moshave dhe numrit të planifikuar të fëmijëve që do të regjistrohen mund t'i gjeni në Institucionin Parashkollor përkatës.

Konkursi do të jetë i hapur prej datës **04 shkurt 2016, deri më 12 shkurt 2016.**

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në Institucionin Parashkollor përkatës çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 15:00.

Shpallja e rezultateve bëhet më së largu me 22 shkurt 2016, në Institucionin Parashkollor përkatës.

Regjistrimi i fëmijëve në Institucionet Parashkollore bëhet bazuar në Kriteret e Regjistrimit të përcaktuara nga Drejtoria Komunal e Arsimit (DKA), sipas vendimit 03 nr. 170, dt. 15.06.2015.

Ndërsa, sa i përket këtij konkursi plotësues, mosha minimale e fëmijëve dhe grup moshave që do të pranohen në IP, do ta përcaktojnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve, por llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marr parasysh datën e regjistrimit por datën e fillimit të shërbimit, përkatësisht duke marr parasysh datën 1 mars.

Nëse nuk plotësohet numri i fëmijëve për sistemim në IP nga kushti i lartcekur, do të merren fëmijët të cilët janë të datëlindjes më të afërt me datën 1 mars.

Të gjithë të pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë **ankesë në Institucionin Parashkollor** përkatës dhe nëse sërish janë të pakënaqur me vendimin e institucionit, atëherë mund të ushtrojnë ankesë në DKA. **DKA nuk e shqyrton asnjë ankesë nëse pala paraprakisht nuk ka përgjigje me shkrim në ankesën e ushtruar në komisionin e Institucionit Parashkollor përkatës.**